




Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI – CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 29 paragrafi 1 pika e) të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 02.05.2012, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK– 03-5111/11, për z. Ilirian Bytyçi, Drejtori Administratës dhe Inspeksionit Komunal ne Komunën e Suharekës (Therandës), për shkak se Zyrtari i Lartë ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt të interesit me numër protokolli AKK–03-5111/11, që për trajtim ka pasur zyrtarin e lartë z. Ilirian Bytyçi, Drejtori i Administratës dhe Inspeksionit Komunal ne Komunën e Suharekës(Therandës).

Pas zhvillimit të procedurës dhe analizimit të gjendjes është konstatuar se zyrtari i lartë publik, gjatë kohës së ushtrimit të funksionit publik ka qenë duke ushtruar pozitë udhëheqëse si pronar dhe person i autorizuar ne Kompaninë “A.B.I SH.P.K” ne Suharekë e që sipas Ligjit për parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik Nr.04/L-051, kjo situatë ka paraqitur konflikt të mundshëm të interesit, dhe mos pajtueshmëri ne ushtrimin e funksionit publik, andaj Agjencia kundër Korrupsionit me datën 07.03.2012, e ka njoftuar zyrtarin e Lartë me shkresën e parë se ka filluar procedura e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të Konfliktit të Interesit dhe se ka të drejte në afatin prej 15 ditësh të njoftohet me faktet qe posedon Agjencia.

Pas këtyre procedurave, z. Ilirian Bytyçi, Drejtori Administratës dhe Inspeksionit, Komunal ne Komunën e Suharekës, ka ardhur të ballafaqohet me faktet qe posedon Agjencia, me datën 16.03.2012 gjatë takimit është biseduar për gjendjen dhe faktet qe disponon Agjencia lidhur me konfliktin e mundshëm të interesit.

Zyrtari i lartë, z.Ilirian Bytyçi, Drejtori i Administratës dhe Inspekcionit, ne Komunën e Suharekës, gjatë takimit është pajtuar për situatën mirëpo është arsyetuar se nuk ka qenë informuar për këtë, pasi që nuk e ka informuar askush që nga momenti i zgjedhjes si Drejtor dhe nuk ka pas njohuri për këtë situatë që mundë të shkaktoj Konflikt të mundshëm të Interesit dhe mos pajtueshmëri ne ushtrimin e funksionit publik.

Zyrtari i Lartë z.Ilirian Bytyçi është zotuar se ne afatin ligjor do të ndërpres udhëheqjen e firmës dhe do ta bej shmangien e Konfliktit të mundshëm të Interesit duke e autorizuar dikën tjetër që të udhëheq firmën gjatë kohës sa ushtron funksionin Publik.

Me datën 23.04.2012, zyrtari i lartë z.Ilirian Bytyçi, Drejtori i Administratës dhe Inspekcionit, ne Komunën e Suharekës brenda afatit ligjore ka sjellë dëshmitë, nga ARBK se i ka bërë ndryshimet ne Biznesin "A.B.I SH.P.K" ne Suharekës, ku dëshmohet se z.Ilirian Bytyçi nuk ka me pozitë udhëheqëse por ka autorizuar një person tjetër si person te autorizuar ne Biznesin "A.B.I SH.P.K".

Ne bazë te kësaj konstatojmë se Zyrtari i Lartë z.Ilirian Bytyçi, Drejtori i Administratës dhe Inspekcionit, ne Komunën e Suharekës ka shmangur Konfliktin e mundshëm te Interesit.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Hasan Preteni
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

